



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMISIONI AD HOC PËR HARTIMIN E DRAFT PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024

Bazuar dhe në zbatim të Vendimit nr.prot.01-016/01-0079522/23 të Kuvendit të Komunës së Podujevës miratuar më 31.10.2023,

N J O F T O N

Për organizimin e konsultimit publik për;

➤ DRAFT PLANIN E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024

- Konsultimi publik fillon nga data **15.12.2023 deri më 15.01.2024**, periudhë brenda së cilës mund të paraqiten propozime, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale në formë të shkruar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit, ndërsa në formë elektronike mund të paraqiten në e-maillet: **info.podujeva@rks-gov.net** dhe **hilmi.hoxha@rks-gov.net**
- Konsultimi publik me qytetarë, grupe dhe subjekte tjera të interesuara mbahet më **09.01.2024**, duke filluar nga ora **14:00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.
- Draft Plani i punës së Kuvendit është pjesë përbërëse e këtij Njoftimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: **http://kk.rks-gov.net/podujeve** (rubrika; aktet për diskutim publik) si dhe në Platformën Elektronike të Konsultimeve publike **https://konsultimet.rks-gov.net/**
- Konsultimi publik zbatohet nga Komisioni ad hoc për hartimin e draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdesen për përgatitjen dhe publikimin e raporteve dhe procesverbaleve nga konsultimi publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimet ose mospranimet të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Podujevë,
datë:15.12.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Draft

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2024

Dhjetor 2024

Parathënie:

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Kuvendi i Komunës, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për.

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

-Si dhe akte tjera që parashihen dhe rregullohen me legjislacion tjetër, varësisht fushave dhe kompetencave përkatëse.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Komuna siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të pa deleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e akteve /dokumenteve të planifikimit hapësinorë, Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Hartës Zonale (HZK), dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRRH), plotësim ndryshimin/revidimin e tyre, si dokumenteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor; dhe
- Iniciativat për themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Për marrjen e vendimeve Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të caktuar të Kuvendit apo Kryetarit të Komunës dhe këtë delegim mund ta tërheqë në çdo kohë.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike dhe planifikohen etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera ligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2024, ku Kuvendi i Komunës së Podujevës planifikon t'i mbaj të paktën 11 (njëmbëdhjetë) seanca të rregullta, 5 deri 6 prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Podujevës, e të cilat janë të rregulluara me proceduara sipas legjislacionit në fuqi, ndër të tjera:

- Planifikon kohën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregulloreve të punës së Kuvendit dhe akteve tjera në fuqi;
- Funksionalizimin e plotë të Komiteteve, komisioneve dhe trupave tjerë të Kuvendit, sipas ligjit, dhe planifikon raportimin e tyre para Kuvendit së paku një herë në vit.
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Planifikon miratimin e buxhetit, planeve investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm, planet rregullative etj.
- Planifikon miratimin e çështjeve tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregulloreve të punës dhe akteve tjera ligjore;
- Planifikon shqyrtimin dhe miratimin e rregulloreve të reja dhe harmonizimin e rregulloreve ekzistuese konform ligjeve në fuqi;
- Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e Ekzekutivit të Komunës;

Përfundim:

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2024 që kanë të bëjnë me interesat e Komunës dhe qytetarëve në përgjithësi.

Me planin e punës janë paraparë 11 (njëmbëdhjetë) seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe eventualisht seanca të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne, siç parashihet me Ligj, Statutin e Komunës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore varësisht fushave dhe kompetencave përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit varësisht nevojave mban takime mujore me përfaqësuesit / shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend, për të bashkërenditur punën e komiteteve obligative dhe funksionale dhe punën e Kuvendit të Komunës.

Për përmbushjen e planit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit aktiviteve, sipas dinamikës të përcaktuar me këtë plan, do të përkujdesen Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteve me Ekzekutivin e Komunës i cili duhet që sa më shumë të jetë e mundur t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2024.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshinë: emërtimin e aktit / dokumentit - objektivin e tij, propozuesin e aktit si organ përgjegjës për përgatitjen të draftit të aktit, afatin e përafërt të procedimit nga propozuesi, shqyrtimet nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2024 sipas nevojave mund të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje dhe çështje të ngritura nga anëtarët e Kuvendit,
- Çështje tjera me rëndësi publike dhe në interes të qytetarëve dhe Komunës.

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2024

JANAR 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Informatë e punës e Asamblesë së Kuvendit Komunal				
2.	Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024				
3.	Plani i punës së KKS-së për vitin 2024				
4.	Plani i Prokurimit për vitin 2024				
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

SHKURT 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Plani për vlerësimin e rreziqeve në Komunën e Podujevës				
2.	Informatë nga Drejtoria e Arsimit				
3.	Informatë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit				
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

MARS 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Rregullore për Taksa Tarifa dhe Gjoba				
2.	Raporti Financiar për vitin 2023				
3.	Informatë nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit				
4.	Informatë nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit				
5.	Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024				
6.	Informatë nga Drejtoria e Inspeksionit				
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

PRILL 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Raporti financiar Janar-Mars 2024				
2.	Informatë për gjendjen e ambientit në Komunën e Podujevës				
3.	Informatë punës nga Zyra e Auditorit të brendshëm				
4.	Informatë nga Drejtoria e Administratës				
5.	Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural				
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

MAJ 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale				
2.	Informatë nga Drejtoria e Pronës , Kadastrit dhe Gjeodezisë				
3.	Raporti i performancës së Komunës për vitin 2023				
4.	Raporti i punës së Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2023				
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

QERSHOR 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB)2025-2027				
2.	Raporti i Auditorit të përgjithshëm				
3.	Rishikimi i buxhetit për vitin 2024				
4.	Plani Komunal për barazi gjinore				
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

KORRIK 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraparak
1.	Raporti 6 mujor nga Kryetari i Komunës				
2.	Raporti Financiar Janar- Qershor 2024				
3.	Caktimi i normave të tatimit në pronë për vitin 2025				
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

GUSHT 2024

Nr.	
1.	Pushim / përveç ndonjë mbledhje për ndonjë çështje apo rrethanë urgjente

SHTATOR 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraparak
1.	Miratimi i Projekt Buxhetit për vitin 2024 dhe projektimit e vitit 2026-2027				
2.	Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përgatitjen e vitit shkollor 2024-2025				
3.					
4.					
5.					
6.					
7.	Të ndryshme				

8.				
9.				
10.				

TETOR 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Raporti Financiar Janar- Shtator 2024				
2.	Informatë e Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale				
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

NËNTOR 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Informatë e Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit				
2.	Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural				
3.	Informatë nga Drejtoria e Inspeksionit				
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

DHJETOR 2024

Nr.	EMËRTIMI I AKTIT / DOKUMENTIT (OBJEKTIVAT)	PROPOZUESI - ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i përafërt i procedimit	Shqyrtimi paraprak
1.	Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2025				
2.	Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit				
3.	Aprovimi i listave të pronave publike për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025				
4.	Informatë Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik				
5.	Informatë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit				
6.	Informatë Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor				
7.	Informatë nga Drejtoria e Administratës				
8.					
9.					
10.	Të ndryshme				

Podujevë
_____ 2023

